

Rekomandime për ngritjen e integritetit dhe profesionalizmit të online mediave

Online sfera në Maqedoni është e ngarkuar me ueb faqe informative të cilët prezantohen si media. Është evidente se niveli i informimit në online sferën është në nivel të ulët. Si të dallohen mediat e “rreme” nga mediat e “rëndësishme” – zgjidhja është në vetërregullimin, e jo në rregullimin

Autor: Zoran Riçliev

Në kohë të fundit, si pasojë e keqpërdorimeve të shumta në sferën e online mediave në Maqedoni thirrjet për “rregullim të portaleve” janë shpeshtuar. Posaçërisht brengos fakti që thirrjet e tilla bëhen nga ana e gazetarëve dhe kryeredaktorëve.

Standardet dhe praktikat botërore, konventat e pranuar ndërkombëtare si dhe debate të shumta, por edhe publikime profesionale e tregojnë të kundërtën – se rregullimi i përmbajtjes të online mediave është i pamundur dhe i panevojshëm. Duhet vetëm të praktikohen me përgjegjësi ligjet ekzistuese.

Por, është evidente se ekzistojnë probleme – online sfera në Maqedoni është e mbushur me ueb faqe informative të cilët paraqiten si media. Fjala e urrejtjes, shpifjet, fyerjet, diskualifikimet, thyerjet e të drejtave të njeriut, thirrjet për shkelje të rendit kushtetues janë shumë prezentë.

Zgjidhja është në vetërregullimin, e jo në rregullimin. Më shumë për këto aspekte mund të lexoni në analizën **“Rekomandime për online media të përgjegjshme”** e cila është komplementare me këto rekomandime.

Mediat nuk vlerësohen sipas mundësive të tyre teknike për të distribuuar informata, por vlerësohen sipas shkallës së objektivitetit me të cilin i ndjekin ngjarjet dhe në drejtim të zbatimit të interesit publik që në opinion të publikojnë lajme cilësore, të kontrolluara dhe objektive të cilët i përmbushin standardet profesionale dhe etike.

Individi ose entiteti i cili informon në internet, nuk ka nevojë të respektojë këto standarde.

Këtu duhet të bëhet edhe dallimi thelbësor mes përmbajtjeve mediatike dhe informimit civil, posaçërisht i përfshirë në rrjetet sociale dhe në bloget, që është karakteristike për ueb faqet në Maqedoni që paraqiten si media, dhe nuk përmbushin as minimum standarde.

Digjitalizimi jo vetëm që e ndryshoi mënyrën e komunikimit të njerëzve, por edhe e transformoi natyrën e gazetarisë dhe etikës. Përderisa mediat e reja i inkurajojnë njerëzit të shprehin atë që e mendojnë, demokracisë i nevojiten gazetarë të pavarur të cilët sigurojnë lajme dhe analiza të paanshme, thotë Dunja Mijatoviç, ish-përfaqësuesja e OSBE për Lirinë e mediave në publikimin:

[Udhëzuesin e OSBE-së për vetërregullimin e mediave.](#)

Por, si duket edhe gazetarët dhe mediat nuk janë adaptuar në sferën e re publike, ku të gjithë kanë mundësi të komunikojnë në mes tyre. Në Maqedoni ato janë adaptuar më pak në krahasim me kolegët e tyre në shtetet e zhvilluara, që rezultoi me degradim të online sferës informuese, që si pasojë e saj solli deri në thirrje naive për rregullim nga ana e shtetit, edhe ato thirrje i bëjnë gazetarë dhe kryeredaktorë.

Fenomeni global i “lajmeve të rreme” dhe adoleshentët nga Velesi, e “popullarizuan” Maqedoninë si El Dorado për krijimin dhe publikimin e lajmeve dhe përmbajtjeve të rreme në internet.

Por, nuk duhet të harrojmë se “liria” e të shprehurit është kyçe në raste të shoqërive jodemokratike. Sipas [analizave](#): Internet-hapësira dhe mediat e internetit në Maqedoni, në periudhën nga viti 2008 deri më vitin 2017, u shndërruan në sferë publike alternative e cila ishte një hapësirë e vogël në të cilën shumë zëra të marginalizuara, neutrale dhe kritike arritën të vijnë në shprehje.

Megjithatë, ky eksplozion i informatave dhe mediave solli edhe shumë sfida për gazetarinë profesionale – nga degradimi i standardeve etike e deri në dilema të shumta ligjore.

Problem tjetër i portaleve (termini edhe pse është shpesh i përdorur është i gabuar, sepse internet-portal është internet hapësirë në të cilën mbledhen përmbajtje nga online media të tjera) është anonimiteti, ose mungesa e identitetit, dhe me atë edhe integriteti. Shumë shpesh online mediat në Maqedoni nuk kanë impresum, nuk shfaqin emrat e autorëve, ndërsa pronësia e mediave për pjesën më të madhe të tyre është mister.

Anonimiteti i cili është karakteristik për të gjithë ueb entitetet dhe lehtësia për të hapur të reja rezultoi me formimin e “paramediave” – entitete të cilët sillen si media, ndërsa në fakt ato: nuk kanë gazetarë, nuk krijojnë përmbajtje autentike, nuk kanë strukturë editoriale dhe nuk janë krijuar që të mbrojnë interesin publik. Fenomen tjetër, i cili është në atë drejtim është procesi i kolonizimit të ueb faqeve informative ekzistuese me integritet të dobët, të përmbledhur në një qendër me agjendë politike të njëanshme.

Thjeshtë, qendrat politike dhe ekonomike morën ose krijuan ueb faqe, qëllimi i të cilëve nuk është të informojnë, por të bëjnë shtrembërimin e opinionit publik me lajme të rreme dhe me propaganda.

Është problematik dhe mjaftë i përhapur mosrespektimi i standardeve gazetareske dhe kodit etik të gazetarëve. Por, më problematike është përhapja e fjalës së urrejtjes dhe mosndëshkimi i Prokurorisë publike në raste të tilla. Mosveprimi, në raste të shumta të diskriminimit, për çka ekziston edhe agjenci e veçantë gjithashtu duhet të observohet dhe hetohet.

Vakumi juridik me mos përfshirjen e online mediave në Ligjet për media duhet të luftohet me informim i të gjithë subjekteve në komunikimin publik për rolin e online mediave, të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe të rregullativës ekzistuese ligjore.

Stimulimi i transparencës, identitetit dhe integritetit të online mediave

Për atë se a bëhet fjalë për lajme të rreme dhe paramedia që bëjnë keqpërdorim, duhet të merret parasysh se a ka media identitetin e vet, dhe me atë a ka edhe integritet.

Ajo arrihet me stimulimin e transparencës së online mediave, si dhe deklarimi i tyre publik për atë se a do të respektojnë standardet etike dhe profesionale.

Online mediat që i respektojnë obligimet ligjore, normat etike dhe standardet profesionale gazetareske duhet të afirmohen si shembull pozitiv dhe të gëzojnë edhe privilegje tjera. Online mediami profesional duhet të ketë pronësi të shfaqur në mënyrë transparente, strukturë të shfaqur editoriale, autorë të nënshkruar në tekstet dhe përmbajtjet, kodi etik të jetë i shfaqur dhe të respektojë atë si dhe politikën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Një nga hapat e mundshëm është ato [kriteret](#) të jenë të domosdoshme për anëtarësim në KEMM.

Në atë drejtim, Këshilli ka iniciativë për krijimin e regjistrit për ueb portale. Sipas kushteve për anëtarësim të KEMM, internet portalet të cilët duan të anëtarësohen, duhet të përmbushin kushte të caktuara, ose të pajtohen se do të respektojnë Kodin e gazetarëve dhe për këtë gjë të vendojnë baner në faqen e tyre kryesore, tekstet e publikuara të jenë të nënshkruara nga autorët etj.

Regjistri duhet të jetë mjet për afirmim të mediave të cilët punojnë në mënyrë profesionale dhe etike dhe në asnjë rast nuk guxon të ketë kriteret të cilët do të jenë diskriminuese.

Vetërregullimi aktiv dhe sanksionet morale publike

Për arsye se rregullimi shtetëror i përmbajtjeve të online mediave nuk është i preferuar, as i mundur (sipas të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare, konventat e nënshkruara, mundësitë teknike, dalja e rregullativës ligjore jashtë kufijve të saj etj.), ndërsa në situatë të keqpërdorimeve të shumta, me të cilët ballafaqohemi, duhet të zmadhohen aktivitetet në lidhje me vetërregullimin.

Organet vetërregulluese i caktojnë kufijtë mes të drejtave legjitime të mediave të lira dhe të drejtave legjitime të njerëzve që tërheqin vëmendje mediatike, thotë OSBE në udhëzuesin për vetërregullimin në mediat nga viti 2016.

Në udhëzuesin e njëjtë, Miklosh Harashti përfaqësuesi i OSBE për lirinë e mediave thotë: “Vetërregullimi mediatik paraqet përpjekje e profesionistëve të mediave që të krijojnë udhëzime vullnetare editoriale dhe të përmbahen në to gjatë procesit të mësimin, i cili është i hapur për publikun. Me atë, mediat e pavarura e pranojnë pjesën e tyre të përgjegjësisë për cilësinë e diskursit publik në vend, njëkohësisht, duke e mbrojtur në tërësi pavarësinë e tyre editoriale në formimin e diskursit”.

Organe të vetërregullimit në Maqedoni janë Këshilli për etikë në media (KEMM) dhe Këshilli i nderit në ShGM.

Duhet KEMM dhe Këshilli i nderit të shndërrohen në mbrojtës të vërtetë i të drejtave të publikut dhe mediave, ose në ombudsman mediatik, veçanërisht në lidhje me online mediat të cilët nuk janë të rregulluara me Ligjin për media.

Ndoshta për shkak të sfidës, do të duhet të zmadhohen edhe kapacitetet e KEMM dhe të Këshillit të nderit në lidhje me mediat digjitale.

Ana pozitive e vetërregullimit është se mundëson fleksibilitet dhe paraqitet në rolin e mekanizmit për mbrojtje nga përzjerja e mundshme e qendrave të fuqisë në përmbajtjet mediatike, ndërsa dobësi e tij është se shqipton vetëm sanksione morale dhe nuk mund të detyrojë aksion pa vullnetin e mediumit i cili ka bërë shkelje.

Shkrim-leximi medial i mediave digjitale

Veprues kryesor në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara me zhvillimin e shpejtë të komunikimeve digjitale janë:

- Mediat
- Publiku
- Sistemi juridik

Ndryshimi i strukturës së mediave nga subjekte të mëdha në numër të madh të subjekteve të vogla, të cilët kanë rol aktiv në informimin e publikut është shfaqur në profesionalizmin dhe kuptimin e komunikimeve publike nga ana e gazetarëve, posaçërisht në kontekst të komunikimeve digjitale. Redaksitë janë gjithnjë më të vogla, nuk kanë hierarki të qartë, dhe posedojnë kapacitete të kufizuara, që sjellë deri në akumulim të kufizuar dhe transmetim të diturisë.

Ekzistojnë shumë online media ku nuk ka asnjë gazetar profesional, ose individ i cili teorikisht dhe në mënyrë praktike e kupton rolin e mediumit në shoqëri demokratike. Kulti i amatorit, si person i cili pranon dhe zbaton urdhra jo etike dhe përdor teknika të PR-it, përkundër dëshirës të madhe për objektivitet të gazetarëve profesionistë ndikoi shumë në zgjidhjen e të punësuarve në mediat.

Një nga tre rolet universale, edukimi, është seriozisht i zvogëluar; Kapacitetet e mediave në lidhje me shkrim-leximin medial të brendshëm janë zvogëluar, ndërsa me atë edhe roli i tyre në edukimin e publikut.

Nevojitet ad-hok proces i edukimit të gazetarëve dhe punonjësve mediatik në fushën e komunikimeve digjitale, si në kontekst teknik, ashtu edhe në aspekt të komunikimit, madje edhe në aspekt juridik.

Roli dhe aktiviteti i mediave është publik. Me zvogëlimin e cilësisë së përmbajtjeve mediatike bëhet ndikim i keq në aspekt të edukimit të publikut, i cili nuk do të thotë se ka njohuri mediatike që të bëjë dallim mes përmbajtjeve etike dhe jo etike, mes gënjeshtërisë dhe të vërtetës, mes informimit dhe propagandës.

Rezultati final është paraqitja e lajmeve të rreme dhe ndikimi i tyre në informimin e publikut dhe shtrembërimi i diskursit publik.

Në këtë proces, mund të shikohet edhe në aspektin pozitiv. Keqpërdorimet e ballafaquan publikun me nevojën që të kontrollojnë vërtetësinë e informatave të cilët i pranojnë. Mënyra më e lehtë për ta bërë atë është të mbështeten në mediat të cilët kanë kredibilitet, që paraqet një trend pozitiv.

Në kohë të njëjtë, është paraqitur nevojë e qartë për përfshirje të shkrim-leximit medial në procesin arsimor. Nuk guxon të injorohet fakti se nxënësit janë më të avancuar në përdorimin e komunikimeve digjitale nga arsimtarët e tyre. Që nuk është rast me kuptimin e përmbajtjes dhe etikës. Njohuritë e nxënësve duhet të plotësohen me standarde dhe udhëzime etike, që në fakt vlejnë edhe online edhe offline.

Mënyrë tjetër për edukim të publikut që ka kryer procesin arsimor, përveç nëpërmjet të përmbajtjeve mediatike janë fushatat publike, prezantimet dhe punëtoritë.

Praktika e moszbatimit të ligjeve dhe mosndëshkimit në lidhje me platformat digjitale nga ana e organeve juridike, gjithashtu ka të bëjë me mungesën e shkrim-leximit medial. Në rastin e gjykatave, rekomandohen punëtori, seminare, ose formim i shërbimeve profesionale, të cilët do të mundësojnë kuptim më të mirë të kësaj problematike.

Për funksionim normal dhe të pavarur të mediave nevojitet edhe treg i drejtë i reklamimit. Dija është në anën e agjencive dhe Shoqatës IAB Maqedoni dhe ato, si dhe marketing agjencitë duhet të kyçen në proceset për ngritjen e nivelit të shkrim-leximit medial, si dhe në debate dhe grupe të punës për krijim të zgjidhjeve për zhvillimin e online reklamimit.

Në kuadër të shkrim-leximit medial bën pjesë edhe rekomandimi për dialog mes ligjvënësit, gjykatësit dhe gazetarët, ndërsa edhe me ekspertët për komunikime digjitale dhe reklamim digjital.

Konkluzion

Nevojitet praktikë në të cilën mediat do ta garantojnë integritetin e tyre me identitet transparent në lidhje me: pronësinë, strukturës editoriale, autorë, politika e privatësisë si dhe me përpjekjet publike dhe garancia se do të respektojnë standardet etike dhe profesionale.

Lista pozitive siç është regjistri në bazë vullnetare të KEMM, është një nga mënyrat e legjitimitit të mediave profesionale dhe etike.

Nëpërmjet të shkrim-leximit medial të gjithë vepruesit të online sferës publike duhet të njoftohen me të drejtat, obligimet, përparësitë dhe sfidat e tyre.

Thirrjet për rregullim shtesë të online sferës do të sjellin deri në rregullim të tepërt. Vetërregullimi është mënyrë më e shpejtë dhe më efikase për zgjidhje të problemeve nga rregullimi.

Duhet të përforcohen kapacitetet dhe roli i Këshillit për etikë në media dhe Këshillit të nderit në ShGM në mënyrë që të bëhen ombudsmanë të vërtetë të publikut, posaçërisht në lidhje me online sferën.

Burime të përdorura:

1. OSBE, Udhëzues për vetërregullimin në mediat online 2013. Në dispozicion në <http://www.osce.org/mk/fom/316166>
2. OSBE, Udhëzues për vetërregullimin në media 2016. Në dispozicion në <http://www.osce.org/mk/fom/316171?download=true>
3. Rregulla për anëtarësim në KEMM, Në dispozicion në <http://semm.mk/sovet-za-etika-4/pravila-za-chlenstvo>

Ky aktivitet është pjesë e projektit “Platforma rajonale për avokimin e lirisë së mediave dhe sigurinë e gazetarëve të Ballkanit Perëndimor”. Përmbajtja e kësaj analize është në përgjegjësi të plotë të ShGM-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet e Bashkimit Evropian.